



Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit
Permanent Tribunal of Arbitration

Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit
Oda Ekonomike e Kosovës
Permanent Tribunal of Arbitration
Kosovo Chamber of Commerce

Zyra Nr.22, Nëna Tereze, Nr.20,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +381 (0) 38 780 313
Fax: +381(0) 38 224 299
info@kosovo-arbitration.com
www.kosovo-arbitration.com

Kuvendi i Odës Ekonomike të Kosovës, duke u bazuar në nenin 17 pika (h) të Ligjit Nr. 2004/7 për Odën Ekonomike të Kosovës me datën 21 Dhjetor 2022, miraton:

KODIN E ETIKES PËR ARBITRA

Kodi i Etikës ka për qëllim të përcaktojë standardet e sjelljes dhe etikën e arbitrave, duke u bazuar në vlerat dhe parimet e Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit të Kosovës (tutje TPAK), siç janë: pavarësia, paanshmëria, integriteti, llogaridhënia, transparenca dhe profesionalizmi.

PRANIMI I DETYRAVE

1. Arbitri duhet të pranojë emërimin vetëm nëse konsideron se është i aftë që në mënyrë të paanëshme dhe në afatin adekuat e përmbushë detyren e vet.
2. Arbitri duhet ta pranojë emërimin vetëm nëse ka njohuri të mjaftueshme për ligjin i cili rregullon procedurën dhe për të drejten kometente për esencen e kontestit.
3. Arbitri duhet të pranojë emërimin vetëm nëse mjaftueshme e dinë procedurën e arbitrazhit.

PAANËSIA DHE PAVARËSIA

1. Arbitri medeomos duhet të jetë i pavarur nga palët në procedurë.
2. Arbitri ushtron funksionin e tij në mënyrë të pavarur duke u bazuar në ligj dhe Rregulla e arbitrazhit, vlerësimin individual të fakteve pa ndonjë kufizim, ndikime të padrejta, nxitje, presione, kërcnime apo ndërhyrje, direkte apo indirekte nga çdokush e për çfardo arsye, duke ruajtur dhe promovuar pavarësinë në aspektin individual dhe institucional.
3. Gjatë procedurës së arbitrazhit arbitri është i detyruar të veprojë në atë mënyrë që sjellja e tij nuk ngre dyshime për pavarësinë dhe paanshmërinë e tij.
4. Përpara se të pranojë emërimin, arbitri është i detyruar t'ua zbulojë palëve të gjitha rrethanat të cilat mund të vënë në pikëpyetje paanshmërinë ose pavarësinë e tij, për shembull:
 - nëse ka kryer ndonjë detyrë ose urdhër për njërën nga palët;
 - nëse ka interes të drejtpërdrejtë ose indirekt financiar në zgjidhjen e kontestit;
 - nëse ai ka ndonjë informacion konfidencial në lidhje me objektin e mosmarrëveshjes, që është mësuar nga burime jashtë procedurës së arbitrazhit

- nëse ka cfardolloj informacioni konfidencial, i cili ka të bëjë ,e kontestin për të cilin e ka zbuluar nga burimi jashtë procedurës së arbitrazhit.
 - nëse disponon informacione tjera të cilat janë të rëndësishme dhe ndikojne në ruajtjen e paanshmërisë.
5. Arbitri është i detyruar të veprojë në mënyrë të paanshme edhe nëse rrethanat nga pika 3 shfaqen gjatë procedurës.
 6. Nëse arbitri dyshon se ka pasur rrethana të mëvonshme të paraqitura, që mund të ndikojnë në paanshmërinë dhe pavarësinë e tij, ai është i detyruar të informojë menjëherë ta njoftoj Tribunalin dhe palët.
 7. Nëse arbitri konsideron se nuk është në gjendje të përmbushë në mënyrë të paanshme detyrën e tij, ai nuk guxon të pranoj emërimin , madje edhe nese të dyja palët bien dakord me emërimin.

PROCEDURA DHE PËRGJEGJËSIA NË PUNË

1. Arbitri mban nivel të lartë të aftësive profesionale dhe ushtron funksionin e tij në mënyrë profesionale, të përgjegjëshme dhe efikase.
2. Arbitri është i detyruar të zhvilloj procedurën në përputhje me aktet e përgjithshme të Tribunalit.
3. Gjatë procedurës së arbitrazhit, arbitri është i detyruar t'i paralajmërojë palët për mundësin e arritjes së marrëveshjes dhe ti ndihmojë në atë, por pa ua imponuar një zgjidhje. Në rast të arritjes së marrëveshjes, arbitri duhet pasur kujdes që zgjidhja të pasqyrojë vullnetin e vërtetë të palëve.
4. Gjatë zhvillimit të procedurës së arbitrazhit, arbitri është i detyruar të veprojë në atë mënyrë që procedura të kryhet pa shpenzime të panevojshme apo shpenzime në disproporcion me vlerën e objektit të mosmarrëveshjes.
5. Gjatë procedurës së arbitrazhit, arbitri është i detyruar të shmangë takimet e veçanta ose forma të tjera të komunikimit me njërin nga palët lidhur me objektin e kontestit. Nëse një komunikimi i tillë ndodh atëherë arbitri është i detyruar të informojë pa vonesë Tribunalin e Përhershëm të Arbitrazhit, Tribunalin e arbitrazhit, si dhe palën tjerë lidhur me përmbajtjen e takimit-komunikimit.
6. Arbitri ushtron funksionin e tij me durim, me dinjitet dhe korrektësi, si ndaj palëve në procedurë, po ashtu edhe ndaj personave tjerë me të cilet ka kontakt profesional.

KONFIDENCIALITETI

1. Arbitri është i detyruar të ruajë në mënyrë konfidenciale informacionin për të cilat është në dijeni me rastin e zhvillimit të procedurave, përveç nese kjo përbën një detyrim ligjor.
2. Arbitri duhet të respektoj konfidencialitetin e të gjitha takimeve procedurale dhe nuk duhet të bëjë komente publike ose të jap informacione për ndonjë rast.
3. Arbitri duhet që në paraqitje publike të promovojë autoritetin e profesionit të arbitrit.
4. Arbitri ka për detyrim që të përmbahet nga çfardo sqarimi për medime dhe palë tjera të interesuara lidhur me rastet konkrete përveç nese ka autorizim për një gjë të tillë.
5. Arbitri ka për detyrim që të përmbahet nga çfardo komentimi në publik lidhur me performancën dhe efikasitetin e arbitrave, Tribunalit të përfershëm të Arbitrazhit si dhe Tribunalit në përgjithësi.

SHPËRBLIMET DHE KOMPENZIMET

Me pranimin e detyrave arbitri fiton të drejtën vetem për komenzimin e shpenzimeve dhe një shpërblim në pajtim me aktet e brendshme të Tribunalit dhe Rregulloren përkatëse.

URGJENCA E PROCEDURËS

1. Arbitri është i detyruar që procedurën e arbitrazhit ta zhvillojë shpejt dhe të sigurojë që mos të ndodhin vonesa të panevojshme.
2. Nëse gjatë procedurës së arbitrazhit arbitri përjeton rrethana që mund të jenë dukshëm për zvarritjen e procedurës, arbitri është i obliguar që pa vonesë ta njoftojë Gjykatën dhe palët.
3. Pas përfundimit të procedurës së arbitrazhit, arbitri është i detyruar të hartojë dhe ta nënshkruaj vendimin e arbitrazhit në përputhje me aktet e përgjithshme të Tribunalit të arbitrazhit.

KUVENDI I ODËS EKONOMIKE TË KOSOVËS
Prishtinë, 21.12.2022

KRYESUES I KUVENDIT

z. Sami Mazreku



4